



Data: 22.06.2020

Ref.: 582/20D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 81-të të mbajtur më 17.04.2020, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit Heimerer për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2023:
 - Shkencat shëndetësore për profile terapeutike, me specializim në Logopedi, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit Shkenca Shëndetësore për profile terapeutike (BSc) me specializim: Logopedi, Ergoterapi dhe Fizioterapi. AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Heimerer, me qëllim të vlerësimit të këtij programi të studimit. Vizita është realizuar me 18.10.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic, Mladen Krajacic dhe Helvi Kyngas.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 17.04.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Heimerer dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin e programit Shkenca Shëndetësore për profile terapeutike (BSc) me specializim: Logopedi, Ergoterapi dhe Fizioterapi, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se ky program përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.


Ekipit të ekspertëve të akreditimit rekomandon se trajtimi i tri specializimeve si programe te veçanta kontribuojnë në mënyrë të pabarabartë në plotësimin e standardeve të akreditimit.

Si përfundim, ekipi i ekspertëve të akreditimit konstatojnë se programi në fjalë plotëson mjaftueshëm standardet e akreditimit për specializimin Logopedi dhe akreditohehet si në dispozitiv të këtij vendimi, kurse dy specializimet tjera, Ergoterapi dhe Fizioterapi nuk arrijnë të përmbushin në nivel të mjaftueshëm standardet e paraqitura në manualin e akreditimit dhe si rezultat nuk akreditohehen.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Heimerer;
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë